


Shtojca 1**Formulari i kërkesës për leje mjedisore**

Emri i kompanisë	NPSH "SHANTIRI-N"
Lloji i veprimtarisë	Therrtore e gjedheve dhe përpunim i mishit
Vendi/lokacioni ku zhvillon veprimtarinë	Zona kadastrale Petrovë, komuna Prizren Rruga e Transitit Petrovë
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës si dhe vula e kompanisë	Pronar z. Nadir Shantiri
Adresa	Adresa: 97, Adem Jashari, Prizren
Telefoni, fax, e-mail	+383 (0) 44 257 949
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati
Adresa	edonak88@gmail.com +383 49 655 661 Lagja Prishtina e Re, Prishtinë
Përshkrimi i dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesës përfshirë numri e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	Nr. Biznesit: 810602450 Data e regjistrimit: 21.06.2006; përditësim datë 29.09.2025 Vendimi për pëlqim mjedisor: nr. i Prot. 1589-2/16; datë 14.07.2016 Vendim – Leje Ujore, ARPL, nr. i prot.; 262-2/23; datë 18.12.2023 Vendimi - Leje Ujore, Shkarkim, ARPL, nr. i prot.; 261-2/23, datë 18.012.2023 Certifikata e pronësis: 07-029-9225-25; datë 29.09.2025 Kopja e planit: 29.09.2025 Vendimi për legalizim: 04-353/144483/23; datë 27.05.2024 Situacioni i terrenit
Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit (euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë	Po; 190 000.00 euro
Fatura e pagesës së tarifës për leje mjedisore	Po
Aplikacioni origjinal i plotësuar për leje mjedisore në një (1) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD).	Po

Shtojca 2
Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNIEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËENAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	NPSH “SHANTIRI-N”
	Vendi	Petrovë, Prizren
	Adresa	Rr. Adem Jashari - Petrovë, Prizren
	Nr. i tel./fax	Mobile: +383 (0) 44 257 949 +383 (0) 44 126 585
	E-mail	info@shantiri.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	Nr. Biznesit: 810602450 Data e regjistrimit: 21.06.2006
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	Nadir Shantiri
	Nr. i tel./fax	+383 (0) 44 257 949
	E-mail	
1.1.4.	Personi kontaktues përgjegjës për mjedis	Edona Kabashi Kastrati
	Nr. i tel./fax	049 655 661
	E-mail	edonak88@gmail.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	“Shantiri-N” N.P.SH.; Therrtore e gjedheve dhe përpunim i mishit
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	N.P.SH. “Shantiri-N”, ndodhet në zonën kadastrale të Petrovës komuna e Prizrenit.

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT		
2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Lokacioni i ndërtimit të N.P.SH. “Shantiri-N”, Thertore për gjedhë dhe përpunim mishi. Thertorja “Shantiri-N” është ndërtuar në ngastrën kadastrale P–71813063–00149-2, në vendin e quajtur Petrovo, në zonën kadastrale Petrovë, Komuna e Prizrenit. Lokacioni gjendet në koordinatat gjeografike 42°14’56.65” N dhe 20°43’30.99” E, në një lartësi mbidetare prej 373 metrash. Pozita gjeografike e këtij lokacioni është shumë e përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit afarist, për shkak të terrenit kryesisht të rrafshët dhe qasjes së lehtë në rrugën tranzite. Objekti ndodhet në kilometrin e parë (1) në anën e djathtë të kësaj rruge, e cila lidh pjesën verilindore të qytetit të Prizrenit, konkretisht fshatin Lubizhdë, me lagjen Arbanë. Komuna e Prizrenit ka një sipërfaqe prej rreth 640 km² dhe gjendet në pjesën jugperëndimore të Republikës së Kosovës. Ajo kufizohet me komunat Suharekë, Rahovec, Shtërpçë, Dragash dhe Gjakovë.
		
2.2.	Numri kadastral i parcelës	Në parcelën P–71813063–00149–2
2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e	Përshkrimi i lokacionit të thertores dhe objekteve përreth - Thertorja për gjedhë dhe përpunim mishi është ndërtuar në pjesën jugore të qytetit të


	tyre në atë zonë	Prizrenit, konkretisht në zonën kadastrale Petrovë, brenda territorit të Komunës së Prizrenit. Lokacioni gjendet në një zonë me karakter kryesisht industrial dhe afarist. Përreth hapësirës së thertores ndodhen objekte të natyrës industriale dhe afariste, ndërsa në afërsi të menjëhershme nuk ka objekte banimi, çka e bën këtë zonë të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të kësaj natyre. Shumë pranë thertores është e vendosur edhe një fabrikë për prodhimin e dyerve dhe dritareve të plastikës (PVC). Përballë thertores, në një distancë prej 150 deri në 300 metra, ndodhen këto objekte me karakter industrial: • Fabrika për përpunimin dhe zinkimin e metaleve • Baza e asfaltit • Baza e betonit • Fabrika për prodhimin e elementeve të betonit • Fabrika për prodhimin e paneleve sanduiç • Terminali Doganor Po ashtu, në këtë zonë operojnë edhe objekte të tjera afariste, përfshirë: • Pompë për derivatet e naftës • Depo të ndryshme • Restorante dhe objekte të tjera shërbyese 
--	-------------------------	--

		
2.4.	Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Gjendja e vegetacionit dhe biodiversitetit në zonën përreth thertores. Në lokacionin përreth thertores dominon vegetacioni ruderal, i cili shfaqet kryesisht përgjatë rrugëve dhe pranë vendbanimeve. Në këtë zonë janë të pranishme edhe barëra të këqija, të cilat rriten zakonisht në tokat djerrina, në kufijtë e parcelave, si dhe përgjatë hapësirave të pashfrytëzuara. Në afërsi të objektit ndodhen edhe tokëra të kultivuara me kultura bujqësore sezonale, që dëshmojnë për një aktivitet bujqësor aktiv në këtë pjesë të komunës. Megjithatë, duhet theksuar se në zonën përreth thertores janë të pranishme edhe objekte tjera me karakter industrial, që e bëjnë zonën të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive ekonomike të ngjashme. Sa i përket biodiversitetit dhe ndikimi në faunë, Komuna e Prizrenit, përfshirë edhe fshatrat përreth, paraqet një zonë me llojllojshmëri të pasur të faunës, duke përfshirë specie të ndryshme të shtazëve të egra dhe shpendëve. Megjithatë, sipas gjendjes faktike në terren, parcela ku është ndërtuar objekti i thertores nuk ndikon negativisht në faunën lokale, pasi ndodhet në një zonë e cila nuk përbën habitat të ndjeshëm apo të mbrojtur për gjallesat

		vendore. Nuk janë evidentuar ndikime të drejtpërdrejta apo të tërthorta që do të dëmtonin biodiversitetin në këtë zonë.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Sipas të dhënave zyrtare të Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, nuk ka evidenca që tregojnë se territori në afërsi të lokacionit ku është ndërtuar thertorja për gjedhë dhe përpunim mishi bën pjesë në ndonjë zonë të mbrojtur ligjërisht, apo që paraqet ndonjë habitat natyror me rëndësi të veçantë për biodiversitetin. Po ashtu, kjo zonë nuk është e identifikuar si territor potencial për t’u futur nën mbrojtje të veçantë, sipas dokumenteve planifikuese apo strategjike të mbrojtjes së natyrës në Republikën e Kosovës. Megjithatë, në një distancë më të largët nga lokacioni i thertores, në territorin e Komunës së Prizrenit, ekzistojnë disa zona të veçanta me status të mbrojtur, si: • Parku Kombëtar “Sharri” • Kalaja e Prizrenit • Ura e Gurit • Objekte të kultit religjioz me vlerë kulturore dhe historike Këto zona nuk ndikohen nga aktivitetet që zhvillohen në lokacionin ku është ndërtuar thertorja dhe ndodhen jashtë zonës së ndikimit të saj të drejtpërdrejtë.

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet leja mjedisore

3.1.1.	Skema e procesit teknologjik	Skema e procesit teknologjik në shtojcën 1 të Aplikacionit 
3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Procesi teknologjik i thertores dhe përpunimit të mishit Përshkrimi i thertores për therjen dhe përpunimin e mishit – “Shantiri-N” N.P.SH.

		Thertorja “Shantiri-N” NPSH është një objekt i vetëm ndërtimor, i cili është i ndarë në hapësira të veçanta funksionale sipas nevojave të procesit teknologjik. Ndërtimi dhe organizimi i brendshëm janë bërë në përputhje me standardet higjieno-teknike për therje dhe përpunim mishi. Hapësirat funksionale të thertores: 1. Zyra e administratës 2. Hyrja për punëtorët, ku realizohet dezinfektimi para hyrjes në zonën e punës 3. Dhoma për ndërrimin e rrobave të punës 4. Hapësira për therjen e gjedheve 5. Dhoma për copëtimin e mishit dhe eshtrave 6. Hapësira për mbajtjen dhe përpunimin e dokumentacionit dhe shënimeve 7. Dhoma e ftohjes 1 (komore frigoriferike) – temperaturë: -2°C deri +3°C 8. Dhoma e ftohjes 2 (komore frigoriferike) – temperaturë: -30°C 9. Zona për depozitimin e mbeturinave të kafshëve 10. Shtalla për mbajtjen e bikave para therjes 11. Objekti për ruajtjen/depozitimin e lëkurave 12. Sistemi për ndarjen/separimin e gjakut dhe yndyrës (separatorë) Pajisjet dhe makineritë e instaluar në linjën e përpunimit: 1. Boksi për therjen e gjedheve 2. Vinçe për pezullimin dhe lëvizjen e kafshëve gjatë procesit 3. Sharra elektrike për copëtimin e eshtrave dhe mishit 4. Frigoriferë për ruajtjen e mishit në temperaturë konstante 5. Makinë për bluarjen e mishit 6. Mikser për përzierjen e përbërësve të mishit 7. Kompresorë për nevoja teknike 8. Peshore për matjen e peshës së mishit dhe nënprodukteve 9. Furra për tharjen e mishit dhe prodhimin e suxhukut 10. Automjete transportuese për shpërndarjen e produkteve
--	--	---

	Fazat e procesit teknologjik në thertore Procesi i therjes dhe përpunimit zhvillohet në një linjë të vetme teknologjike, e dedikuar për kafshë të trasha, konkretisht gjedhë. Therja kryhet manualisht, me ndihmën e mjeteve mekanike bazike, pa përdorim të teknologjive të rënda ose të sofistikuara, duke iu afruar në mënyrë të ndjeshme metodave tradicionale të therjes. Fazat kryesore të procesit përfshijnë: 1. Pranimi dhe strehimi i kafshëve në shtallë 2. Dezinfektimi i stafit dhe përgatitja për punë 3. Therja manuale e gjedheve në bokse të posaçme 4. Gjakderdhja dhe grumbullimi i gjakut në sistemin e separatorëve 5. Heqja e lëkurës dhe ndarja e organeve të brendshme 6. Copëtimi i mishit dhe eshtrave me sharra elektrike 7. Peshimi dhe klasifikimi i mishit 8. Ftohja dhe ruajtja në komore frigoriferike 9. Përpunimi shtesë (nëse aplikohet), si bluarje, përzierje, tharje ose paketim 10. Transportimi i produkteve të përfunduara me automjete të përshtatshme <i>Qëndrimi i përkohshëm i gjedheve:</i> Gjedhet e blera nga tregu vendor apo të importuar, sillen në objektin e thertoresh përkatësisht në shtallën e saj, për qëndrim të përkohshëm. Aty kafshët marrin ushqim dhe ujë, ndërsa qëndrimi i tyre aty është i shkurtër dhe mirë i planifikuar sipas kërkesave të tregut për mish dhe produktet e mishit.
--	--



Shtalla e thertores është e shtruar me beton dhe e pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për mbajtjen e përkohshme të gjedheve para therjes.

Kontrolli veterinar

Para se të vendosen në shtallë, të gjitha gjedhet i nënshtrohen një kontrole rutinore veterinare nga veterineri i kontraktuar nga thertorja. Ky kontroll ka për qëllim të sigurojë që në procesin e therjes të mos futen kafshë të sëmura apo me probleme shëndetësore.

Pushimi i gjedheve

Gjedhet zakonisht pushojnë për rreth 12 orë në hapësirat e shtallës. Gjatë kësaj periudhe atyre u ofrohet ushqim dhe ujë i mjaftueshëm për pije, duke siguruar mirëqenie para procesit të therjes.

Evidentimi i gjedheve

Çdo gjedhë identifikohet me numra për qëllime evidentimi dhe kontrolli. Në rast të dyshimit për sëmundje ose gjendje të dobët shëndetësore, kafsha në fjalë kontrollohet nga veterineri dhe merret vendimi përfundimtar nëse ajo duhet të theret apo jo. Therja e kafshëve të sëmura është e ndaluar.

Procesi i therjes së gjedheve

Therja realizohet kryesisht në mënyrë mekanike dhe manuale, duke përdorur mjete të përshtatshme për qëllimin, si:

- Sharra elektrike për prerje
- Vinça për mbajtjen dhe lëvizjen e gjedheve
- Bokse të posaçme për vendosjen e gjedheve gjatë therjes


Ky proces i ngjan mënyrave tradicionale të therjes, duke respektuar gjithashtu edhe metodën Halall për therjen, siç kërkohet për standardet fetare dhe etike.

Derdhja e gjakut dhe lëvizja e trupit

Pas therjes, gjaku derdhet plotësisht dhe më pas gjedhi lëviz në mënyrë vertikale drejt pjesës tjetër të thertores, ku:


- Bëhet kullimi i plotë i gjakut
- Gjedhi ngrihet në mënyrë profesionale me ndihmën e vinçave elektrike të posaçëm për vazhdimin e procesit të përpunimit





Lirimi i gjakut

Lirimi i gjakut të gjedheve të therura bëhet në hapësirën e veçantë për grumbullimin e gjakut dhe dërgimin e tyre në seperatorët që janë të ndërtuar në oborrin e jashtëm të thertorës. Seperatorët për grumbullimin e gjakut dhe ujit kanë një kapacitet të mjaftueshëm për grumbullimin e tyre. Sasia e gjakut që lirohet është rreth 4-5% të peshës trupore të gjedhit.



Rrrjepja, heqja e kokës dhe largimi i pjesëve tjera të gjedhit të cilat konsiderohen si mbeturinë.


Pas therjes së gjedheve, fillon procesi i rrjepjes dhe largimit të organeve të brendshme dhe mbeturinave të tjera. Më pas, trupat e prera të gjedheve kalojnë në sektorin përkatës ku realizohet copëtimi i tyre në pjesë të ndryshme. Mbeturinat e kafshëve grumbullohen në kontenierë të veçantë dhe dërgohen për menaxhim nga kompani të licencuara për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve të kafshëve.

Prerja, copëtimi dhe inspektimi

Në këtë fazë, gjedhi pritët në dy pjesë kryesore me ndihmën e sharrave elektrike të specializuara për këtë aktivitet. Më pas, mishi inspektohet nga inspektori veterinar i autorizuar për të siguruar cilësinë dhe sigurinë ushqimore. Pas inspektimit, mishi transportohet në frigoriferë për ruajtje në temperatura të përshtatshme.

Ftohja dhe ngrirja e mishit

Pasi mishi është shumë i ndjeshëm dhe ka rrezik të prishjes së shpejtë, pas çdo prerjeje ai ruhet në frigoriferë me temperatura të kontrolluara nga rreth -0.5°C deri në $+4^{\circ}\text{C}$. Kjo fazë është thelbësore për ruajtjen e cilësisë dhe sigurisë së mishit deri në momentin e shitjes.



Vulosja e mishit

Vulosja e mishit kryhet nga veterinarët përgjegjës, të cilët certifikojnë se mishi është i shëndetshëm dhe i përshtatshëm për konsum njerëzor. Ky vulosje është dëshmi që mishi mund të shitet ligjërisht konsumatorëve.

Menaxhimi i mbetjeve të eshtrave

Një pjesë e mishit shitet si mish me eshtra, ndërsa pjesa tjetër ndahen eshtrat nga mishi dhe përpunohet më tej. Eshtrat që mbeten nga copëtimi grumbullohen në kontenierë të veçantë dhe më pas merren nga kompani të licencuara për trajtimin e tyre.

Përpunimi i mishit dhe prodhimi i suxhukut dhe mishit të tharë

Kompania “Shantiri-N” N.P.SH. kryen edhe prodhimin e suxhukut, proshutës dhe mishit të tharë. Për këtë qëllim, në thertore është instaluar linja e prodhimit e posaçme, e cila përfshin:

- Grirjen e mishit
- Përzierjen me shtesa të ndryshme për përgatitjen e masës së suxhukut
- Mbushjen e suxhukut në trupa të përshtatshëm



			
3.1. 3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	Hënë - Premte Orari i punës 08:00 – 17:00 E shtunë Orari i punës 08:00 - 14:00	
3.1. 4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Sipas kapacitet të projektuar është rreth 10 – 15 gjedhe në ditë. Ndërsa, kapaciteti i realizuar i therjes së kafshëve është 2 – 3 gjedhe në ditë. Sasia e suxhukut të tharë është rreth 100 – 150 kg/javë. Sasia e mishit të tharë është rreth 40 – 50 kg/javë.	
3.1. 5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse.	Kafshët siç janë: gjedhet dhe deleve. Aditivët të ndryshëm (kripa e kuzhinës, speci djegës, qepa, etj) Energjia elektrike Uji	
3.1. 6.	Lista e rezervuarëve dhe kapaciteti i tyre	Kompania “Shantiri-N” N.P.SH., në thertoren e vendosur në zonën kadastrale Petrovë, nuk posedon rezervuarë për deponimin e karburanteve të lëngëta apo të gazta. Ndërsa, kompania disponon rezervuarët e impiantit për trajtimin e ujit të përdorur gjatë procesit teknologjik.	
3.1. 7.	Lista e legjislacionit ne fuqi	Lista e Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative për kompletimin e kërkesës për tu pajisur me leje mjedisore. Ligjet:	

		• Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 • Ligji për VNM Nr. 08/L-181 • Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 • Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110 • Ligji nr. 08/l-112 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/l-26 për tokën bujqësore • Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233 • Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 • Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11 • Ligji nr. 08/l-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-197 për kimikate • Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025. • Ligji për mbeturina Nr.08/L-071 për plotësim ndryshimin e ligjit për mbeturina Nr. 04/L-60. • Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 • Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012 Udhëzimit Administrative: • Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit Administrativ (Mmph) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore • Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore • Udhëzimi administrativ Nr.07/2017 për Lejen Mjedisore • Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2014 për kompetencat e zotëruesit të mbeturinave, prodhuesit dhe importuesit të produktit. • Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për metodologjinë e zvoglimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat për eliminimin e pasojave. • Udhëzimi administrativ për menaxhimin e deponive të mbeturinave (15/2012)
--	--	---

		• Udhëzimi administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujorë. • Udhëzimi administrativ për administrimin e mbeturinave të rrezikshme (06/2008) • Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2013 Për katalogun Shtetrorë të Mbeturinave
--	--	--

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

3.2.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Thertorja “Shantiri-N” N.P.SH., me aktivitet kryesor therjen, përpunimin dhe shitjen e mishit, është e përkushtuar që të gjitha funksionet e saj organizative t’i kryejë në përputhje me standardet më të larta për mbrojtjen e mjedisit. Kompania synon përmirësime të vazhdueshme për të përmbushur të gjitha detyrimet ligjore dhe për të siguruar një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor, të bazuara në standardin ISO 14001, ofrojnë mundësinë për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin efektiv të aspekteve mjedisore të organizatës, me synimet kryesore: - Përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes së mjedisit - Parandalimin e dëmtimit të mjedisit - Respektimin e legjislacionit vendor në fuqi - Përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me autoritetet kompetente
3.2.2.	Raportimi	Raportimi do të kryehtë nga udhëheqësit e kompanisë, ku do të ti paraqesin të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda viti, të cilat do të raportohen autoriteteve përkatëse sipas kërkesës së tyre.

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE		
4.1.	Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse	Pikat kryesore të burimit të emisioneve dhe materieve ndotëse në thertoren janë: • Pluhurat që lirohen nga automjetet e transportit dhe operacionet e ngarkim-shkarkimit të kafshëve të dedikuara për therje, si dhe materialeve të nevojshme në proces. • Tymi i krijuar gjatë tymosjes së mishit dhe suxhukut në procesin e përpunimit. • Pluhurat që shkaktohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operacionale brenda lokacionit të thertores. • Gazrat e lëshuara nga automjetet e transportit, gjeneratorët dhe pajisje të tjera mekanike.
4.2	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Duke marrë parasysh origjinën organike të pluhurit dhe tymit të krijuar gjatë djegies së materialit të copëtuar (tallash), si dhe faktin se objekti ndodhet në një zonë me prezencë të natyrshme të bimësisë, ndikimi në mjedis konsiderohet i kufizuar dhe jo negativ. Në çdo rast, përqendrimet e pluhurit dhe tymit në ajër janë brenda kufijve të lejuar sipas legjislacionit mjedisor në fuqi, gjë që është e verifikueshme nëpërmjet matjeve dhe kontrolleve periodike të cilësisë së ajrit. Faktorët ndikues në cilësinë e ajrit Cilësia e ajrit ndikohet ndjeshëm nga faktorë meteorologjikë dhe karakteristikat klimatike të zonës. Kjo nënkupton se: • Përqendrimi i ndotësve në ajër mund të variojë sipas stinëve dhe gjendjes së motit • Në periudha me qarkullim më të lartë të ajrit (erë, reshje), shpërndarja e ndotësve është më efikase • Nuk ka rrezik për ndotje ndërkufitare, duke marrë parasysh vendndodhjen gjeografike të thertores

		Burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë; • Tymi i krijuar nga procesi i tymosjes së mishit dhe suxhukut, ku si lëndë djegëse përdoren materiale drurore (tallash), me përmbajtje të ulët të substancave toksike • Gazrat e lëshuara nga automjetet e transportit dhe makineritë e rënda të përdorura gjatë bartjes së gjedheve • Pluhurat e krijuara nga rrugët dhe sipërfaqet operative që nuk janë të asfaltuara Masa lehtësuese dhe kontrolluese; • Monitorimi periodik i cilësisë së ajrit dhe krahasimi me standardet ligjore në fuqi • Mbatja nën kontroll e pluhurit përmes ujitjes apo asfaltimit të sipërfaqeve të hapura • Përdorimi i makinerive dhe automjeteve me efikasitet të lartë dhe me emetime të ulëta • Organizimi i procesit të tymosjes në ambiente të mbyllura dhe të ventilueshme, për të kufizuar përhapjen e tymit
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten nga pluhurat të cilët lirohen nga qarkullimi i automjetet jashtë thertrës. - Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të kafshëve. - Pluhurat të cilët lirohen gjatë procesit të ngarkim – shkarkimit. - Pluhurat të cilat lirohen nga pllatoja e shtallës së kafshëve Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponenteve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NO_x, HxCy, SO₂ dhe Pb. Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para së gjithash nga kushtet klimatike meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin në fjalë.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e	Thertrorja “Shantiri-N” N.P.SH., me aktivitet kryesor therrien, përpunimin dhe shitjen e mishit, nuk ka të instaluar pajisje për trajtimin

	gazrave shkarkuese	e gazrave shkarkuese, sepse procesi teknologjik i cili përdorët për këtë veprimtari nuk gjeneron pluhura ap emisione të gazërave shkarkuese në sasi të madhe për të instaluar system për trajtimin e gazërave.
4.5.	Pajisjet për de-pluhurin	Gjithmonë bëhet spërkatja e sipërfaqeve të jashtme, rrugëve transportuese, sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta (gjatë verës).
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Therrtorja “Shantiri-N” N.P.SH., me aktivitet kryesor therrjen, përpunimin dhe shitjen e mishit, nuk bën monitorim te emisioneve.
4.7.	Monitorimi i emisioneve/ cilësisë ë ajrit	Therrtorja “Shantiri-N” N.P.SH., me aktivitet kryesor therrjen, përpunimin dhe shitjen e mishit, nuk bën monitorim te emisioneve dhe pluhurit.
4.8.	Raportimet	///
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Për të minimizuar ose parandaluar ndikimet negative në cilësinë e ajrit gjatë zhvillimit të aktivitetit në thertoren dhe përpunimin e mishit, operatori i thertores “Shantiri-N” N.P.SH. ka ndërmarrë një sërë masash të qëndrueshme, si më poshtë: • Spërkatja e rregullt e sipërfaqeve të hapura, veçanërisht në zonat ku realizohet ngarkim-shkarkimi dhe qëndrimi i kafshëve, për të reduktuar pluhurin dhe grimcat në ajër. • Mirëmbajtja periodike dhe higjiena e hapësirave ku qëndrojnë kafshët, për të parandaluar krijimin e ndotësve të ajrit dhe përhapjen e aromave të pakëndshme. • Kontrolli teknik i rregullt i automjeteve transportuese, me qëllim parandalimin e lirimit të tepërt të gazrave ndotës nga motorët me djegie të brendshme. • Spërkatja e sipërfaqeve manipuluese dhe rrugëve të brendshme të thertores, sidomos gjatë stinës së verës dhe në ditë me erë, për të parandaluar përhapjen e pluhurit.

		- Funksionaliteti i vazhdueshëm i hidranteve me ujë, që janë gjithmonë në gatishmëri për ndërhyrje të menjëhershme në rast nevojë për pastrim ose zvogëlim të ndotjes. - Menaxhimi i menjëhershëm i mbetjeve të krijuara gjatë procesit të therjes, duke i larguar nga hapësirat operative dhe dërguar në deponi të licencuara, për të shmangur akumulimin dhe ndotjen e ajrit.
4.10.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Masat për Zvogëlimin e Ndikimeve në Ndryshimet Klimatike; Reduktimi i përdorimit të karburanteve fosile - Përdorimi i automjeteve me efikasitet të lartë energjetik ose me emetime të ulëta. - Zëvendësimi i gjeneratorëve klasikë me alternativa më ekologjike (p.sh., inverterë me energji diellore ose biogaz). Efikasiteti energjetik - Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive me konsum të ulët energjie. - Instalimi i ndriçimit LED dhe sistemeve automatike për kontrollin e ndriçimit dhe temperaturës. Menaxhimi i mbetjeve organike - Kompostimi ose dërgimi në impiante për prodhimin e biogazit për të shmangur emetimin e metanit (CH₄). - Reduktimi i hedhjes së mbeturinave organike në deponi. Zëvendësimi i lëndëve djegëse me biomasë të qëndrueshme - Përdorimi i tallashit apo drurit të përpunuar me kontroll të emetimeve gjatë procesit të tymosjes. Ulja e ndotjes nga transporti

		○ Konsolidimi i transporteve për të reduktuar numrin e lëvizjeve. ○ Kontroll teknik i rregullt për të ulur emetimet nga automjetet.
--	--	--

5. UJI

5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Kompania “Shantiri-N” N.P.SH., thertore e gjedheve dhe përpunim i mishit, ujin për shfrytëzim e merr nga ujërat nëntokësor-pusi privat që gjindet në oborrin e therrtorës, i cili uji me pompa nxjerret nga pusi dhe shfrytëzohet për nevojat e thertorës. Gjithashtu, uji për shfrytëzim merret edhe nga rrjeti i ujësjellësit.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	Ujërat e ndotura që krijohen në thertoren “Shantiri-N” N.P.SH. janë rezultat i aktiviteteve të ndryshme që zhvillohen gjatë procesit teknologjik dhe atij mbështetës. Këto ujëra ndahen sipas burimit në: • Ujëra industriale të gjeneruara nga procesi i therjes, përpunimit të mishit, shpëlarjes së produkteve dhe pajisjeve, si dhe gjakderdhjes së kafshëve. • Ujëra sanitare që rrjedhin nga objektet sanitare të përdorura nga punonjësit. • Ujëra atmosferike të krijuara nga reshjet atmosferike dhe pastrimi i sipërfaqeve të jashtme. Burimet kryesore të ndotjes së ujërave përfshijnë: • Proceset e therjes dhe përpunimit të mishit • Shpëlarja e brendshme e objekteve, makinerive dhe sipërfaqeve të punës • Qëndrimi i kafshëve në shtallë, ku ujërat ndoten nga urina dhe jashtëqitjet • Pastrimi periodik i hapësirave të brendshme dhe rrugëve operative

		Thertorja “Shantiri-N” N.P.SH. posedon sistem të ndërtuar për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, i cili përfshin: • Bazenin sedimentues dhe trajtues, ku ujërat grumbullohen dhe i nënshtrohen një procesi fillestar të pastrimit fizik dhe ndarjes së ndotësve të ngurtë ose organik. • Izolimi i rrjedhjes së drejtpërdrejtë, ku sigurohet që asnjë ujë i ndotur nuk shkarkohet në ujërat sipërfaqësore (lumenj, përroi) dhe as në rrjetin komunal të kanalizimit. • Pas trajtimit fillestar në bazenin sedimentues, ujërat trajtohen si mbetje industriale të lëngëta. • Grumbullohen dhe transportohen nga kompani të licencuara, të cilat janë të specializuara për trajtimin dhe eliminimin e ujërave të ndotura sipas standardeve ligjore dhe teknike në fuqi.
5.3.	Ndikimet në ujë	Aktivitetet që zhvillohen në thertoren “Shantiri-N” N.P.SH. mund të shkaktojnë ndikime potenciale në mjedisin ujor, të cilat vijnë kryesisht nga burime të ndryshme operationale dhe mbështetëse të objektit. Këto ndikime ndodhin kryesisht si rezultat i aktiviteteve të mëposhtme: Burimet direkte të ndotjes: • Gjatë procesit të therjes së kafshëve, ku ujërat ndoten nga gjaku, mbetjet organike dhe lëngjet trupore. • Pastrimi i hapësirave të brendshme dhe pajisjeve, ku përdoren ujë dhe detergjentë industrialë që përmbajnë përbërës kimikë. • Qëndrimi i kafshëve në shtallë, ku ujërat ndoten nga urina dhe jashtëqitjet. • Larja e sipërfaqeve të jashtme, si rrugët operative dhe zona e ngarkim-shkarkimit, të cilat mund të mbajnë ndotës nga aktivitetet ditore. Burimet indirekte të ndotjes: • Mbeturinat e lëngëta me vajra dhe detergjentë, të cilat vijnë nga lavatriqet, makineritë, pastrimi i mjeteve ose dysHEMEVE industriale.

		• Derdhja e vajrave dhe yndyrave nga automjetet transportuese, që parkohen ose operojnë në hapësirat e brendshme dhe të jashtme. • Shkarkimet aksidentale të ujërave të zeza, në rast të defekteve në sistemin sanitar. • Ujërat atmosferike, të cilat, gjatë reshjeve, mund të përziejnë ndotësit nga sipërfaqet e ndotura dhe t'i shpërndajnë në mjedis.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Thertore “Shantiri-N” N.P.SH. nuk përcakton emisionet e ujërave të ndotura sipas Udhëzimit Administrativ nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave në rrjet të kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.
5.5.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Kompania “Shantiri-N” N.P.SH., që operon në zonën kadastrale Petrovë të Komunës së Prizrenit, ka vendosur një sistem të organizuar për menaxhimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikat e qëndrueshme mjedisore. Aktualisht, ujërat e ndotura i nënshtrohen trajtimeve fizike përmes infrastrukturës së ndërtuar për këtë qëllim. Ujërat e ndotura grumbullohen përmes sistemit kolektor të brendshëm, që mbulon të gjitha zonat operative të thertoresh. Ky sistem përfshin gypa dhe kanalizime të dedikuara për të gjitha llojet e ujërave: industriale, sanitare dhe atmosferike. Derdhjet e mundshme të vajrave dhe derivateve nga automjetet transportuese kapen përmes një sistemi të integruar gypor, që i dërgon në separatorin për pastrimin e ujqit të ndotur me substanca të yndyrshme. Ujërat e përdorur në nyjet sanitare dhe ato që krijohen gjatë përpunimit të mishit kanalizohen në separatorin për trajtim të ujqit me yndyrna, vajra dhe detergjentë.

		Pas trajtimit fillestar, këto ujëra kalojnë në gropën septike, e ndërtuar me tre vaska, ku vazhdon trajtimi më i thelluar i mbetjeve të lëngëta. Është instaluar një sistem i ujëmbledhësve periferik, përgjatë rrugëve dhe parkingut të thertores, që mundëson grumbullimin e ujërave atmosferike, duke parandaluar përzierjen e tyre me ujërat industriale ose sanitare. Bëhet pastrimi i rregullt i puseve sedimentuese, separatorit dhe neutralizuesit, për të siguruar funksionalitetin dhe shmangien e ndotjeve aksidentale. Ujërat e zeza, pas trajtimit në gropën septike, nuk shkarkohen në recipientë natyrorë ose në mjedis pa u trajtuar më parë. Pas trajtimit në sistemin e gropës septike dhe separatorit, ujërat përmbajnë: ○ Yndyrna dhe vajra: $\leq 1 \text{ mg/l}$ ○ Materia të pezulluara (suspenduara): $\leq 30 \text{ mg/l}$ Këto parametra janë brenda kufijve të lejuar sipas legjislacionit mjedisor në fuqi në Kosovë. Ujërat dhe mbetjet nga gropa septike dhe separatorët pastrohen dhe largohen periodikisht nga kompani të licencuara për trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve të lëngëta industriale.
--	--	---

		
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Operatori/thertore “Shantiri-N” nuk bënë kontrolle dhe matje.
5.7.	Raportimi	Operatori/thertore “Shantiri-N” nuk bënë raportime.
5.8.	Leje ujqorë për shfrytëzim të ujit	Operatori/thertore “Shantiri-N” posedon leje për shfrytëzimin e ujit. Vendim – Leje Ujqore, ARPL, nr. i prot.; 262-2/23; datë 18.12.2023
5.9.	Leje ujqorë shkarkimin e ujërave	Operatori/thertore “Shantiri-N” posedon leje për shkarkimin e ujit. Vendimi - Leje Ujqore, Shkarkim, ARPL, nr. i prot.; 261-2/23, datë 18.012.2023
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Bazuar në vlerësimin e karakteristikave të lokacionit dhe natyrës së aktivitetit, nuk pritet të ketë ndikime të konsiderueshme në tokë dhe ujë si rezultat i funksionimit të impiantit për therjen dhe përpunimin e mishit nga kompania “Shantiri-N” N.P.SH. Kjo për shkak të masave parandaluese tashmë të ndërmarra dhe infrastrukturës së instaluar për menaxhimin e mbetjeve të lëngëta. Karakteristikat e lokacionit • Pjesa më e madhe e sipërfaqes së parcelës është e gjelbëruar me bimësi ruderal (bar). • Sipërfaqet e dedikuara për qarkullimin e automjeteve dhe operacioneve teknike janë të shtruara me kubëza betoni, që parandalojnë infiltrimin e ndotësve në tokë. Burimet potenciale të ndotjes së ujit dhe tokës • Larja e pajisjeve të therjes, që mund të gjenerojë ujëra të ndotura me mbetje organike, përfshirë gjakun dhe yndyrat.

		• Reshjet atmosferike, të cilat mund të shpërndajnë ndotës nga sipërfaqet operationale në tokë ose sistemin natyror të ujërave. • Depërtimi i vajrave dhe derivateve nga automjetet nëse nuk menaxhohen siç duhet. Masat për minimizimin e ndikimeve; ○ Të gjitha ujërat që rezultojnë nga proceset e larjes dhe therjes grumbullohen në sistem të mbyllur, dhe dërgohen në impiantin e ndërtuar të trajtimit fizik (bazonet). ○ Pas trajtimit fillestar, ujërat kanalizohen në gropën septike, e më pas merren dhe pastrohen nga kompani të licencuara për trajtimin e ujërave të ndotura. ○ Ujërat nga nyjet sanitare kanalizohen drejt gropës septike, ku i nënshtrohen trajtimit bazik para se të transportohen për trajtim të mëtejshëm. ○ Është ndërtuar një sistem i ujëmbledhësve përgjatë rrugëve dhe objekteve për mbledhjen dhe kontrollin e ujërave nga reshjet. ○ Ujërat atmosferike nuk përzihen me ato industriale apo sanitare dhe ridrejtohen në mënyrë të kontrolluar. ○ Investitori është i përkushtuar të respektojë të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe burimeve ujore.
--	--	---

6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	Bazuar në natyrën e aktivitetit të ushtruar në thertoren “Shantiri-N” N.P.SH., nuk pritet që zhurma e gjeneruar të tejkalojë nivelet e lejuara dhe as të paraqesë shqetësim për mjedisin përreth, përfshirë banorët e zonës.

		- Thertorja operon vetëm me një ndërrim të rregullt prej 8 orësh gjatë ditës. - Aktivitetet kryesore zhvillohen në ambient të mbyllur, me infrastrukturë të përshtatur për zbutjen e zhurmës. - Zona ku ndodhet objekti është zonë industriale dhe afariste, me distancë të konsiderueshme nga zonat e banimit. Burimet e zhurmës: - Pajisjet teknologjike në linjat e therjes dhe përpunimit të mishit. - Automjetet transportuese dhe logjistike. - Makineritë ndihmëse (kompresorë, vinça, etj.) Standardet për nivelin e lejuar të zhurmës: <table><tr><td>Koha e Ditës</td><td>Niveli Maksimal i Lejuar i Zhurmës (dB)</td></tr><tr><td>Dita (07:00 – 19:00)</td><td>50 dB</td></tr><tr><td>Nata (19:00 – 07:00)</td><td>45 dB</td></tr></table> <i>Neni përkatës i bazuar në standardet ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Udhëzimet Administrative për Mbrojtjen nga Zhurma në Kosovë.</i> <table><tr><th rowspan="2">Zhurma</th><th colspan="4">Distanca (m)</th></tr><tr><th>10</th><th>50</th><th>100</th><th>500</th></tr><tr><td>90db – niveli Për pajisje moderne</td><td>59</td><td>45</td><td>39</td><td>25</td></tr></table> Bazuar në distancën e objekteve përreth dhe kohën e operimit të thertores, nuk parashikohet ndonjë tejkallim i standardeve të zhurmës. Gjithashtu, duke qenë se aktivitetet zhvillohen vetëm gjatë orarit ditor kur edhe lëvizja e qytetarëve dhe zhurma ambientale është më e lartë, ndikimi i perceptuar nga komuniteti është minimal.	Koha e Ditës	Niveli Maksimal i Lejuar i Zhurmës (dB)	Dita (07:00 – 19:00)	50 dB	Nata (19:00 – 07:00)	45 dB	Zhurma	Distanca (m)				10	50	100	500	90db – niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25
Koha e Ditës	Niveli Maksimal i Lejuar i Zhurmës (dB)																					
Dita (07:00 – 19:00)	50 dB																					
Nata (19:00 – 07:00)	45 dB																					
Zhurma	Distanca (m)																					
	10	50	100	500																		
90db – niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25																		
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Operatori/thertore “Shantiri-N” nuk bënë kontrole dhe matje të zhurmës.																				
6.3.	Raportimet	//																				

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Aktivitetet që zhvillohen në këtë impiant/thertore nuk kanë ndikim të madh në tokë, përveç atyre ndikimeve që kanë qenë në hapësirën e ndërtimit të objektit. Ndërsa jashtë parcelave të kompanisë ndikimet në toke nuk do të ketë, pasi që nuk ka ndonjë aktivitet që paraqet tryzni anësore. Nga shkarkimi i ujërave pas procesit të prodhimit nuk do të ndodh ndotja e tokës pasi impiantit për therjen e kafshëve ka ndërmarre të gjitha masat për evitimin e ndotjes së ambientit duke ndërtuar gropën septike për trajtimin e ujërave të ndotur. Ndërsa ndikime tjera si derdhje e vajrave etj, nuk ka. Gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit, ndotja e tokës ndodhë si: • Ndikime në tokë mund të pataqiten nga deponimi i mbeturinave shtazore. • Nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga procesi I therjës. • Mbeturinat të ndryshme organike dhe jo organike të cilat krijohen nga punëtorët. • Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkarohen nga derdhjet e vajrave dhe yndyrave. • Automjetet të cilat i përkasin therrtores dhe qëndrojnë në parging të therrtores.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Për të parandalur apo minimizuar sasinë e ndikimeve negative në tokë të cilat i kemi cekë më lartë ndërmirren këto masa: • Në mënyrë të rregulltë mirëmbahen stabilimentet të cilat nevojiten për realizimin e procesit të prodhimit. • Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në therrëtore grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre. • Mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen dhe kalsifikohen në kontainer të posacëm të pajisur me kapak për mbulim, me

		transport vetanak apo përmes kompanisë transportohen deri tek deponit regjionale. • Vajërat motorike dhe ato të makinave duhet të vëndosen në enë të posacme dhe të dorëzohen në ndërmarrje të licencuara për grumbullimin e vajërave të përdorur. • Sipërfaqet jo funksionale janë mbjellur me bari dhe me drujë dekorativ gjethe mbajtës.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Pas përfundimit të aktivitetit të thertores, pajimet e impiantit duhet të çmontohen dhe të largohen nga ky lokalitet. Bazamentet si dhe platotë duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në depononte regjionale. Struktura përfundimtare duhet të jetë e mbuluar me dheun, e cila është adekuate me dheun e mëparshëm dhe ku do të përshtatet substratit të tokës. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara apo të degraduar nga ndryshimi i destinimit do të përfshij rivitalizimin në tërësi të hapësirës së dëmtuar nga veprimtaria ekzistuese. Zgjedhja e rikultivimit, dmth modelit, varet edhe nga qëllimi i përdorimit të tokës, siç do të jetë e paraparë me planet komunale.

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE		
8.1.	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	Gjatë operimit të impiantit për therje dhe përpunim të mishit nga kompania “Shantiri-N” N.P.SH., si rezultat i aktivitetit teknologjik dhe veprimeve mbështetëse të personelit, gjenerohen disa lloje mbeturinash që ndahen në: <i>Mbeturina nga procesi i therjes dhe përpunimit të mishit:</i> Këto janë mbetje me origjinë shtazore që dalin gjatë therjes së kafshëve dhe përpunimit të mishit dhe përfshijnë: - Gjaku - Organe të brendshme të papërdorshme për konsum - Lëkura

	- Eshtë të mbetura - Mbetje yndyre dhe pjesë të tjera jo të konsumueshme Këto mbeturina menaxhohen në përputhje me legjislacionin përkatës dhe merren nga kompani të licencuara për menaxhimin dhe asgjësimin e mbetjeve shtazore. <i>Mbeturina komunale dhe higjienike nga aktiviteti i përditshëm:</i> Mbetje organike dhe inorganike nga aktiviteti i personelit (ambalazhe, letra, mbetje ushqimore, etj.) - Paketimi i materialeve të përdorura - Mjete të konsumuara të pastrimit Këto mbetje grumbullohen në kontejnerë dhe dorëzohen te ndërmarrja komunale për menaxhimin e mbeturinave në Prizren. <i>Klasifikimi i mbeturinave sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave:</i> <table><tr><th>Kodi</th><th>Përshkrimi i mbetjeve</th></tr><tr><td>02 01 06</td><td>Mbetje të bimëve nga bujqësia (nëse ka ushqim për gjedhe)</td></tr><tr><td>02 02 01</td><td>Mbetje nga mishrat e papërpunuar (mish i skaduar, i padëshiruar)</td></tr><tr><td>02 02 02</td><td>Mbetje nga yndyrna dhe vaji organik</td></tr><tr><td>02 02 03</td><td>Mbetje që nuk janë të përshtatshme për konsum ose përpunim më tej</td></tr><tr><td>02 02 04</td><td>Mbetje të lëkurës dhe indeve</td></tr><tr><td>02 02 99</td><td>Mbetje të tjera jo të specifikuara nga përpunimi i mishit</td></tr><tr><td>15 01 01</td><td>Ambalazhe nga kartoni dhe letra</td></tr><tr><td>18 02 02</td><td>Mjete të përdorura mbrojtëse ose mjekësore (si doreza njëpërdorimshe, në rastet kur trajtohen kafshë të sëmura)</td></tr><tr><td>18 02 03</td><td>Mbetje nga trajtimi i kafshëve potencialisht infektive</td></tr><tr><td>20 01 01</td><td>Letra dhe kartona nga aktiviteti i përditshëm</td></tr><tr><td>20 01 08</td><td>Mbetje biologjike të biodegradueshme</td></tr></table>	Kodi	Përshkrimi i mbetjeve	02 01 06	Mbetje të bimëve nga bujqësia (nëse ka ushqim për gjedhe)	02 02 01	Mbetje nga mishrat e papërpunuar (mish i skaduar, i padëshiruar)	02 02 02	Mbetje nga yndyrna dhe vaji organik	02 02 03	Mbetje që nuk janë të përshtatshme për konsum ose përpunim më tej	02 02 04	Mbetje të lëkurës dhe indeve	02 02 99	Mbetje të tjera jo të specifikuara nga përpunimi i mishit	15 01 01	Ambalazhe nga kartoni dhe letra	18 02 02	Mjete të përdorura mbrojtëse ose mjekësore (si doreza njëpërdorimshe, në rastet kur trajtohen kafshë të sëmura)	18 02 03	Mbetje nga trajtimi i kafshëve potencialisht infektive	20 01 01	Letra dhe kartona nga aktiviteti i përditshëm	20 01 08	Mbetje biologjike të biodegradueshme
Kodi	Përshkrimi i mbetjeve																								
02 01 06	Mbetje të bimëve nga bujqësia (nëse ka ushqim për gjedhe)																								
02 02 01	Mbetje nga mishrat e papërpunuar (mish i skaduar, i padëshiruar)																								
02 02 02	Mbetje nga yndyrna dhe vaji organik																								
02 02 03	Mbetje që nuk janë të përshtatshme për konsum ose përpunim më tej																								
02 02 04	Mbetje të lëkurës dhe indeve																								
02 02 99	Mbetje të tjera jo të specifikuara nga përpunimi i mishit																								
15 01 01	Ambalazhe nga kartoni dhe letra																								
18 02 02	Mjete të përdorura mbrojtëse ose mjekësore (si doreza njëpërdorimshe, në rastet kur trajtohen kafshë të sëmura)																								
18 02 03	Mbetje nga trajtimi i kafshëve potencialisht infektive																								
20 01 01	Letra dhe kartona nga aktiviteti i përditshëm																								
20 01 08	Mbetje biologjike të biodegradueshme																								

		Masat për menaxhimin e mbetjeve: Mbetjet shtazore të rrezikshme dhe të pa përshtatshme për konsum mbledhen në kontejnerë të veçantë të mbyllur, në kushte të kontrolluara higjienike. Kompania ka kontratë me kompani të licencuara për grumbullim dhe asgjësim të mbetjeve shtazore. Mbetjet komunale ditore të personelit grumbullohen dhe largohen përmes ndërmarrjes komunale të mbeturinave. Operatorët zbatojnë praktika për ndarje dhe klasifikim të mbetjeve që nga vendi i gjenerimit.
8.2.	Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Thertore “Shantiri-N” N.P.SH., me aktivitet kryesor therjen dhe përpunimin e mishit, nuk bënë magazinim apo deponim të mbeturinave.
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Thertore “Shantiri-N” N.P.SH., me aktivitet kryesor therjen dhe përpunimin e mishit, nuk bënë përpunim dhe riciklim të mbeturinave.
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër-kontratë me kompaninë me leje përkatëse	Thertore “Shantiri-N” N.P.SH., me aktivitet kryesor therjen dhe përpunimin e mishit, nuk bënë trajtim dhe riciklim të mbeturinave me operatorët tjerë.
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Plani i menaxhimit me mbeturina përfshinë aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut. Plani për menaxhimin e mbeturinave përmban, masat e zbatuara me qëllim të parandalimit të krijimit të mbeturinave, zvogëlimit të sasisë së tyre zbatimin e masave dhe teknikave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut, përcaktimin e mënyrës për magazinimin, trajtimin, në raste më të veçanta riciklimin dhe deponimin

		e mbeturinave. Klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr.04/L-060 - Menaxhimin me mbeturina komunale të cilat duhet të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor. - Menaxhimin me vajrat mbeturinë të cilat duhet të grumbullohen dhe të vendosen në fuqi të mbyllura dhe të siguruar.
8.6.	Raportimi	//

9. RREZIKU NGA AKSIDENTET

9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Plani i mbrendshëm do të përmbajë: Objektivat e Planit: ➤ Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve, ➤ Ruajtja dhe mbrojtja e ambientit, ➤ Vlerësimi i rrezikut, parandalimi i zjarreve mbrojtja dhe ruajtja e pasurisë dhe të mirave materiale, Qëllimi i planit: Qëllimi i hartimit të këtij Plani është: • Zvogëlimi të rrezikut, • Gatishmëria për të marrë vendime të duhura dhe kordinimi i veprimeve (në raste të zjarreve përmasash të mëdha), • Krijimi i prioriteteve për një kordinim sa më efikas në mes të subjekteve të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe me efikasitet në rastet e fatkeqësive – zjarreve. Plani i jashtëm Qëllimet kryesore të këtij Plani janë: Tërheqja e vëmendjes së përdoruesve dhe të autoriteteve përkatëse ndaj mundësisë së ndodhjes së një aksidenti dhe zbatimit të masave për shmangien e tij, të shmangë
------	---	--

		efektet serioze (si p.sh. vdekjet nga aksidentet), te zvogëlojë shfaqjen e efekteve, të zvogeloje rrezikun e ndodhjes së aksidenteve ose të zbusë pasojat e aksidenteve kur ato ndodhin. Për realizimin e objektivave të mësipërme, ky plan përmban këto qështje kryesore: ekipet e emergjencave dhe përgjegjësit e tyre, trajnimi i punëtorëve, klasifikimi i territorit sipas kategorise së kërcënimit nga aksidentet, përgjegjësitë.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Operatori në thetrotore nuk përdorë substanca të rrezikshme kimike apo përparate të ngjashme.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Kompania ka marrë masat për të parandaluar aksidentet apo dhe zvogëlimin e tyre: Plani i mbrojtjeve nga zjarri, si dhe aftësimi i të punësuarve për përdorimin e duhur të paisjeve kunder zjarrit. Është rrethuar tërë oborri i fabrikës me murë dhe tel qëmbor. Janë marrë të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajimet tjera, Janë marrë të gjitha masat e sigurisë për kyçjen e automjeteve transportuese në rrugën pa penguar komunikacionin. Pronari mbanë evidencën dhe ruan shënimet për dërgimin e tyre ne qendrat e licencuara për riciklim, për sasinë dhe llojin e mbeturinave të seleksionuara, dhe sasinë dhe llojin embetjeve nga mbeturinat, me qëllimqe të vërtetohet dalja e mbeturinave ne këtë lokacion (vendi për grumbullimin e mbeturinave). Evidenca dhe shënimet mbahen sipas rekomandimeve që jepen në Ligjin për Mbeturin Nr. 02/L-30 dhe Udhëzimeve administrative për mbeturina të hartuara sipas rekomandimeve nga Ligjin për Mbeturina Nr. 04/L-060.

		Janë marrë të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës. Meqënëse natyra e punës së fabrikës i ekspozohet më shumë rrezikut nga rrjarri, kompania ka marrë keto masa: • Për shuarjen e zjarrit përdoren aparatet mobile zjarrfikëse që janë të vensoura në vendet më efikas. • Zakonisht vendosen dy aparate mobile zjarrfikëse të tipit (S9) dhe një arkë me rërë. • Është ndërtuar sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë. • Në rastet kur kemi rrjedhje të vajrave dhe lubrifikanteve, atëherë vendi ku janë derdhur duhet të pastrohet me absorbues kimik apo me ashkla të imta druri të cilat me lopata mblidhen dhe futen në fuqi ku mbahen në depo deri sa të merën nga kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre. • Kontrollohen rregullisht korrektësinë e instalimeve elektrike. • Kontrollohet dhe monitorohet ambientit e kompleksit të fabrikes. • Evakuimi i personave të cënueshëm nga objektet. • Janë marrë masat e sigurisë kundër vënjes së qëllimshme të zjarreve.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Raporti i sigurisë duhet të përmbajë këto të dhëna dhe informata: Shënimet e lokacionit ku gjendet fabrika, duke përfshirë pozitën gjeografike, kushtet meteorologjike, gjeologjike dhe hidro-grafike, të dhënat mbi terrenin; përcaktimi i stabilimenteve dhe aktiviteteve të tjera të therretorës “Shantiri-N” N.P.SH. të cilat mund të paraqesin rrezik nga aksidentet e mëdha; përshkrimi i zonave ku mund të vijë deri te efekti dominon nga aksidenti i madh, përshkrimi i aktiviteteve kryesore, burimit të rrezikut nga aksidentet e mëdha dhe rrethanave nën të cilat një aksident i tillë mund të ndodhë si dhe përshkrimi i masave

		preventive të planifikuara; përshkrimi i procedurave, në rend të parë mënyra e punës; Përshkrimi i substancave të rrezikshme, i cili përfshin: Sasinë më të madhe të substancave të rrezikshme që mund të jenë te pranishme në lokacion; vetitë fizike, kimike dhe toksikologjike të substancave të rrezikshme dhe paralajmërimet e rrezikut për njeriun dhe Mjedisin, vërtetimin e substancave të rrezikshme: emërtimi kimik, numri CAS (Chemical Abstract Simbol), emërtimi sipas nomenklaturës IUPAC. Vërtetimi dhe analiza e rrezikut nga fatëkeqësitë dhe mënyra e pengimit. Vlerësimi i pasojave të konstatuara nga aksidenti i madh. Përshkrimi i pajisjeve të shfrytëzuara gjatë sigurimit të stabilimenteve. Përshkrimi detal i rrjedhjes së mundshme të aksidenteve të mëdha dhe mundësisë së ndodhjes së tyre ose kushtet nën të cilat mund të ndodhin, duke përfshirë përshkrimin e situatës që mund të shkaktojnë në njërin nga zhvillimet e cekura të saj, pa marrë parasysh se a janë shkaktarët brenda stabilimentit ose jashtë tij; Masat mbrojtëse dhe masat për intervenim për kufizimin e pasojave të aksidentit: Përshkrimi i pajisjeve në stabilimente të shfrytëzuara për kufizimin e pasojave nga aksidentet e mëdha; organizimi i alarmimit dhe intervenimi, përshkrimi i mjeteve të jashtme dhe të brendshme që janë në dispozicion;
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Në rast të aksidenteve mjedisore-zjarri, mbrojtja planifikohet të bëhet evakuimi i detyrueshëm i personave në rrezik nga ndërtesa ku ka ndodhur zjarri kritike për të siguruar objektivin themelor të mbrojtjes së njerëzve dhe ndërtesës nga zjarri. Ndodhja aksidentale e zjarrit shkakton një situatë mjaft stresuese, dhe reagimi i njerëzve është i paparashikueshëm. Për dallim nga çdo ditë duke e lënë objektin në përdorim normal, evakuim të detyruar në rast një zjarr ndodh papritur,

	pa mundësinë e parashikimit të tij. Elementet paniku, i cili është i pranishëm në situata të tilla, vetëm e vështirëson evakuimin. Procedurat e evakuimit në rast zjarri ➤ Të sigurojë evakuimin e sigurt të personave të cënueshëm dhe pajisjeve të vlefshme, ➤ shuarja dhe lokalizimi i zjarrit dhe ruajtja e integritetit dhe stabilitetit të ndërtesës. Parandalimi i zjarrit në ndërtesë zbatohet në mënyrë më efektive nga aplikimi materiale jo të djegshme në elemente strukturorë kudo që të jenë të jetë e mundur. Në këtë drejtim, duhet të bëhet zëvendësimi i materialit që është më lehtë i ndezshëm ose ka një fuqi termike më të lartë, me një material që ka një temperaturë më të ulët ndezja dhe prodhimi më pak i nxehtësisë. Një masë aktive gjithashtu përfshin zvogëlimin sasia e përgjithshme e ngarkesës masive të zjarrit në objekt, duke e zvogëluar atë temperatura e procesit termik, përqendrimi i zjarrit, temperatura e flakës dhe shkëndijat etj dhe duhet pasur kujdes edhe për mbajtjen e burimit të nxehtësisë në afërsi të karburantit të temës. Shuarja e flakës së pilotit (e vogël - fillestare) pas humbjes kontrolli i zjarrit është i mundur me mjete të përshtatshme, ndonjëherë edhe me anë të shuarjes një këpucë e zakonshme pranë zjarrit. Për të kontrolluar zjarrin gjatë fillimit faza dhe likuidimi i saj i hershëm është zgjidhja më e mirë duke përdorur pajisjet mobile kunder zjarrit te cilat mund të përdoret nga të gjithë personat . Nëse zjarri nuk arriti të shuhet me një pajisje "S" ose "CO₂", në raste të tilla nevojitet me shumë kontroll i dhe nevojitet më shumë ndërhyrje - duhet të përfshihen me shume njerez me më shumë pajisje (makineritë fillestare të zjarrit dhe rrjeti i brendshëm hidrant). Pas kësaj mund të fillojë me evakuimi, duke pasur parasysh që një numër personash nuk janë kompetent për ekspertin ndërhyrja, dhe në shumë raste ato pengohen nga paniku i tyre ndërhyrje. Për të siguruar evakuimin efikas është i nevojshëm të sigurojë integritetin e strukturës në komunikimet
--	---

		rrugore dhe ambientin karakteristikat nën faktorin e rrezikut në kohën e evakuimit. Një zjarr zjarri duhet të japë mundësinë e suksesit edhe kur pika qendrore është e madhe dhe disa dhjetëra m². Në këtë fazë, instalimet e shuarjes së qëndrueshme përdoren me pjesëmarrjen e anëtarëve të një brigade profesionale zjarri. Procedura e shuarjes kryhet në fazat vijuese: Faza e Parë I - Zjarri përfshin fikjen e energjisë elektrike dhe hyrjen e zjarrfikësve me pajisje të mbajtura me dorë ose ujë nga një rrjet hidrant. Për përdorimin e aparateve të zjarrit të tipit 6 dhe 9 kg të tipit S veprimet duhet të kryhen në rendin e mëposhtëm: Siguroni pajisjen në vend sa më shpejt që të jetë e mundur Zjarri, tërheq levën në valvulën e pajisjes, godet levën e luajtshme në valvulën e pajisjes me pëllëmbën e dorës, prisni 5 sekonda, dhe ktheni grykën drejt zjarrit dhe shtypni gungën plotësisht. Koha e veprimit është 18 sekonda dhe rrezja e është 4 m. Për të përdorur një zjarrfikës 5 CO₂.
--	--	---

10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT		
10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Në rastet se vërehet se kemi funksionim jo stabile të fabrikës, bëhet ndërprerja momentale e punës dhe fillon kontrollimin për të gjetur shkakun, përse nuk kemi rrjedhje normale të punës. Pas gjetjes së defektit dhe rikuperimit të tij, bëhet testimi dhe lëshohet në punë i therrtorës. Ndërsa në kushtë normale nuk ka ndërprerja momentale e punës së therrtorës përveq nese kemi nderprerje momentale të rrymës elektrike. Gjithnjë sipas pronarit të therrtorës.
10.2.	Ndërprerja e punës	Në kushtë normale nuk parashihet për ndalje të punës.

11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT
--

Gjatë funksionimit të vazhdueshëm të thertores së kompanisë “Shantiri-N” N.P.SH., me aktivitet kryesor therjen dhe përpunimin e mishit, në zonën kadastrale Petrovë, Komuna e Prizrenit, nuk pritet të ketë ndikim të ndjeshëm në shëndetin e njeriut, me kusht që të respektohen në mënyrë të plotë: masat e parashikuara në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), kushtet dhe obligimet e përcaktuara në lejen mjedisore dhe legjislacioni mjedisor në fuqi.

Bazuar në natyrën e aktivitetit, llojin e ndotësve të pranishëm dhe distancën nga zonat e banuara, rreziku për ndikim negativ në shëndetin e banorëve përreth është i ulët deri minimal, dhe konsiderohet i kontrollueshëm me masa standarde të mbrojtjes mjedisore dhe sanitare.

Personi përgjegjës për mjedis

Emri mbiemri

Edona Kabashi Kastrati

Nënshkrimi

Personi përgjegjës i kompanisë

Emri Mbiemri

Nadir Shantiri

Nënshkrimi
